



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.33

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9481 datë 16.2.2006	Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë..... 1077
Vendim i KM nr.188, datë 5.4.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.828, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për formën, mënyrën e mbajtjes, elementet përbërëse dhe afatin e përdorimit të dokumenteve nga zyrat e gjendjes civile”..... 1080
Vendim i KM nr.192, datë 21.3.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.596, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, të ndryshuar..... 1080
Vendim i KM nr.194, datë 5.4.2006	Për ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombëtar të Diasporës, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë..... 1081
Vendim i KM nr.197, datë 5.4.2006	Për hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Podgoricë, Mali i Zi..... 1083
Vendim i KM nr.198, datë 5.4.2006	Për pranimet në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006-2007, në sistemin me kohë të plotë, dhe për përcaktimin e tarifës së shkollimit..... 1083
Vendim i KM nr.199, datë 5.4.2006	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme, të datës 19 mars 2006, për kryetar, në komunën Fajzë të qarkut të Kukësit..... 1092
Vendim i KM nr.201, datë 29.3.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e

regullores	së	Këshillit	të	1092
Ministrave”				

L I G J
Nr.9481, datë 16.2.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9418, DATË 20.5.2005 “PËR SIGURIMIN
SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

1. Ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që dalin në rezervë/lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension të parakohshëm, për vjetërsi shërbimi, kur plotësojnë vjetërsinë e shërbimit si ushtarak, në masën 12 vjet për femrat dhe 15 vjet për meshkujt dhe kur kanë mbushur moshën 44 vjeç femrat dhe 47 vjeç meshkujt, në masën e përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.

2. Ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, që kanë dalë në rezervë/lirim nga data 1 janar 1991 deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, pavarësisht nga çasti i lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, do të vazhdojnë ta përfitojnë këtë pension, sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

1. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është 50 për qind e pagës referuese.
2. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese.
3. Masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se:
 - a) gjashtëfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ushtarakët që mbajnë gradën gjeneral;
 - b) pesëfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr.7703,

datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ushtarakët që mbajnë gradën kolonel;

c) katërfishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ushtarakët që mbajnë gradat major dhe nënkolonel;

ç) trefishi i pensionit bazë, në datën 1 janar të çdo viti, sipas përcaktimit të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për të gjithë ushtarakët e tjerë.

4. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur ushtaraku përfitues rikthehet në shërbimin aktiv.

5. Në rast të punësimit të ushtarakut përfitues në sektorin publik, masa e përfitimit nga pensioni i parakohshëm, për vjetërsi shërbimi, do të jetë sa një pension bazë në shkallë vendi.

6. Në rast punësimi në vende të tjera pune gjatë kësaj periudhe, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të jetë deri në kompensimin e pagës, mbi të cilën është llogaritur kjo pagesë dhe jo më shumë se masa e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, por, në çdo rast, jo më pak se masa e pensionit bazë në shkallë vendi.

7. Periudha, për të cilën ushtaraku përfiton pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni të plotë pleqërie, sipas pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi për këtë kategori përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet mbi bazën e pagës referuese, mbi të cilën është llogaritur pensioni i parakohshëm, por në çdo rast brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët e indeksimit të pensioneve.”.

Neni 3

Në paragrafin e tretë të nenit 16, shprehja “60 për qind” zëvendësohet me shprehjen “50 për qind”.

Neni 4

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Indeksi dhe rillogaritja

1. Përfitimet suplementare, që jepen sipas neneve 15, 17 e 21 të këtij ligji, indeksohen aq herë dhe në atë masë që indeksohen pensionet e përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përfitimet suplementare, që jepen sipas neneve 12, 13, 19 e 23 të këtij ligji, rillogariten sa herë që ndryshon paga referuese, me të cilën është bërë llogaritja e këtyre përfitimeve.”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 28 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ushtarakët, që plotësojnë kushtet për përfitim sipas këtij ligji dhe të cilëve, njëkohësisht, u lind e drejta të përfitojnë nga ligjet nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension” dhe nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave oficerë dhe nënoficerë, lundruer, të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare në pension”, kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet tyre.”.

Neni 6

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Pensioni suplementar për ushtarakët në pension para vitit 1991

1. Ushtaraku në pension, që ka përfituar pension pleqërie para vitit 1991, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ata që kanë përfituar pension pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension suplementar si ushtarak.

2. Masa e pensionit suplementar është e njëjtë me masën e pensionit të llogaritur në nenin 16 të këtij ligji.”.

Neni 7

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

Njohja si periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë

1. Për të gjithë ata ushtarakë, që kanë dalë në rezervë apo lirim dhe plotësojnë kushtet për pension pleqërie pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, periudha 1.10.1993 deri 31.12.1998 u njihet periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë, sipas kushteve të mëposhtme:

a) ushtarakët e nxjerrë në rezervë/lirim gjatë kësaj periudhe, të cilët kanë përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në çastin e lindjes së të drejtës së përfitimit të pensionit të pleqërisë, t'u derdhet masa e kontributit sipas pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, për vitin përkatës, për aq vite sa u nevojiten për efekt të përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë, por jo më shumë se periudha e përcaktuar për efekt derdhje kontributi;

b) ushtarakët e nxjerrë në rezervë/lirim gjatë kësaj periudhe, të cilët kanë vjetërsi shërbimi nën 15 vjet për burrat dhe nën 12 vjet për gratë dhe që nuk kanë përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në çastin e lindjes së të drejtës së përfitimit të pensionit të pleqërisë t'u derdhet kontribut, sipas pagës minimale në shkallë vendi, për vitin përkatës, deri në dy vjet për burrat dhe tre vjet për gratë, por jo më shumë se periudha, që u nevojitet për efekt të përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë.

2. Mënyra, kushtet dhe kriteret e zbatimit të kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4, 13, 14, 16 e 31/1 brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.”.

Neni 9

Në nenin 34 afati “1 janar 2006” zëvendësohet me “16 prill 2006”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.188, datë 5.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.828, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR FORMËN, MËNYRËN E MBAJTJES, ELEMENTET PËRBËRËSE DHE AFATIN E PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 19 të ligjit nr.8950, datë

10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe të neneve 15, 23 e 32 të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes” me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.828, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Përmasat e fletëve të dokumenteve të gjendjes civile janë, si më poshtë vijon:

- | | |
|--------------------------------|------------|
| a) Modelet 1 dhe 3 | 30 x 35; |
| b) Modeli 2 | 35 x 45; |
| c) Modelet 4 dhe 5 | 60 x 40; |
| ç) Modelet 6 dhe 7 | 21 x 30; |
| d) Modelet 10, 11, 12, 15 e 16 | 21 x 30; |
| dh) Modeli 13 | 20 x 15; |
| e) Modelet 8 dhe 9 | 25 x 30; |
| ë) Modeli 14 | 20 x 30.”. |

2. Në shkronjën “dh” të pikës 4, Mod 9, pas shprehjes “...me 50...” shtohet shprehja “...dhe 100...”

3. Në pikën 9 emërtimi “Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit” zëvendësohet me “Ministria e Brendshme”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.192, datë 21.3.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.596, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL Durrës
DHE PËR RIORGANIZIMIN E TIJ”, TË NDRYSHUAR


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Aneksi 1/1, që i bashkëlidhet statutit të Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr.596, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me aneksin 1/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**SHËNIME:**

- Drejtori i Forcës së Sigurisë së Portit i jep llogari drejtpërdrejt Drejtorit të Autoritetit Portual
- Shefat e turneve mund të jenë nëninspektor, inspektor ose kryeinspektor
- Një agjent nga secili turn do të emërohet zëvendës i Shefit të Turnit.

VENDIM

Nr.194, datë 5.4.2006

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT KOMBËTAR TË DIASPORËS,
PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 2 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Institutit Kombëtar të Diasporës, në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Instituti Kombëtar i Diasporës koncepton, bashkërendon dhe mbikëqyr politikat për

diasporën.

3. Instituti kryen detyrat e mëposhtme:

- Mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve shqiptare në botë, në bashkëpunim me organe të tjera përgjegjëse, si dhe me organizatat joqeveritare.

- Hartimin e politikave për zhvillimin e diasporës shqiptare, të vjetër dhe të re, si dhe hartimin e politikave dhe analizave për çështjet e migracionit shqiptar në vendet, ku ata ndodhen.

- Analizimin e qëndrimeve politike të qeverisë shqiptare, në përgjithësi, dhe perspektivën e politikave aktuale për mbrojtjen e të drejtave, politike dhe sociale, të komuniteteve shqiptare në botë.

- Përcaktimin e programeve për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve shqiptare në botë.

- Vlerësimin e strategjive ekzistuese apo atyre që do të miratohen, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Migracionit.

- Kryerjen e studimeve të thelluara ekonomike, sociale, arsimore dhe kulturore për dinamikën dhe zhvillimin e komuniteteve shqiptare në botë.

- Përcaktimin e shteteve, ku duhet të veprohet me përparësi për politikën për diasporën.

- Analizimin e qëndrimeve politike të organeve qeverisëse në vendet e tjera për diasporën dhe emigracionin shqiptar në botë.

- Nxitjen dhe mbështetjen e krijimit të grupeve/shoqatave të veçanta të emigrantëve shqiptarë, në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta apo vendndodhjes gjeografike.

- Hartimin e politikave për vlerësimin e rolit investues të biznesmenëve shqiptarë në botë.

- Krijimin e qendrave kulturore shqiptare në vendet pritëse, ku gjendet një komunitet i madh shqiptar, për të promovuar imazhin e Shqipërisë dhe të emigrantëve shqiptarë, si dhe për të ofruar disa shërbime për komunitetin e shqiptarëve.

- Hartimin e politikave për mësimin e gjuhës amtare nga fëmijët në diasporë, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me legjislacionin e vendeve, ku ata jetojnë.

- Përgatitjen dhe trajtimin e udhëzimeve për misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë për çështjet e sipërcituara, si dhe për të siguruar ndihmën e komuniteteve shqiptare, për organizimin e vizitave të personaliteteve të larta shtetërore.

- Komunikimin me strukturat/institutet homologe të vendeve të tjera, të cilat trajtojnë çështje të diasporës dhe migracionit.

4. Personeli i Institutit Kombëtar të Diasporës përbëhet nga një staf prej 4 nëpunësish, drejtori i Institutit dhe 3 specialistë, prej të cilëve, të paktën, njëri prej tyre të jetë diplomat. Ky staf merret me funksionimin dhe menaxhimin e plotë të Institutit. Drejtori i Institutit Kombëtar të Diasporës dhe specialistët emërohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

5. Pranë këtij Instituti do të veprojë një bord drejtues, me përfaqësues në nivel drejtori të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansave të Barabarta, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Bordi drejtues i Institutit Kombëtar të Diasporës të hartojë dhe bashkërendojë politikën për diasporën, duke u bazuar në fushën e kompetencës së ministrive përfaqësuese në bord. Bordi drejtues këshillon dhe rekomandon veprime konkrete, për menaxhimin dhe funksionimin e Institutit për realizimin e politikave për diasporën, si dhe përpunon dhe miraton materiale analizuese, kërkimore, shkencore, për politikën për diasporën në botë.

7. Efektet financiare për veprimtarinë e Institutit Kombëtar të Diasporës të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe nga donacione të ndryshme nga persona, juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, në mbështetje me marrëveshjet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

8. Vendimi nr.216, datë 14.1.1996 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Diasporës Shqiptare”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.197, datë 5.4.2006

**PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË PODGORICË, MALI I ZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006” me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Podgoricë, Mali i Zi.
2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e vitit 2006, t’i shtohet fondi prej 17 966 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.
3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.198, datë 5.4.2006

**PËR PRANIMET NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT E LARTA, PËR VITIN
AKADEMIK 2006-2007, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË, DHE PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHKOLLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve, për degët e studimit me numër të mbyllur, në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006- 2007, në sistemin me kohë të plotë, të jetë 8 440 studentë dhe të ndahet:

A. Kuota e pranimeve të reja për degët e studimit me numër të mbyllur	7 900
B. Kuota për degë të dytë	250
C. Kuota për vite të ndërmjetme	250
D. Kuota për shtetasit e huaj	40
2. Kuota e pranimeve të reja përbëhet nga:	
a) kuota kryesore	6 981
b) kuota dytësore	610
c) kuota për shqiptarët nga trojet	

3. Kuota e pranimeve të reja ndahet sipas shkollave të larta dhe universiteteve. Kuotat kryesore janë sipas tabelës nr.1 dhe kuotat dytësore sipas tabelës nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Për degët për të cilat nuk janë parashikuar kuota e pranimit është e lirë. Këtu nuk janë pasqyruar kuotat për vite të ndërmjetme, për degë të dytë dhe kuotat për studentët e huaj.

4. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovcë dhe Medvegjë, konkurrojnë ndërmjet tyre për kuotat e pranimit, të përcaktuara sipas degëve, në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në shkollat e larta dhe universitetet e Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesave të paraqitura prej shkollave të larta dhe universiteteve.

6. Kuotat e pranimeve për vite të ndërmjetme dhe degë të dytë administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahen sipas kërkesave të paraqitura nga shkollat e larta dhe universitetet.

7. Kandidatët, që do të vazhdojnë studimet në një degë të dytë, e fitojnë atë duke konkurruar me dosje kundrejt kuotave të parashikuara në këtë vendim dhe i nënshtrohen tarifës së veçantë të shkollimit. Masa e tarifës së shkollimit, për degë të dytë, është e barabartë me tarifën e shkollimit për kuotat dytësore. Në rastet kur ka më shumë kandidatë se kuotat e përcaktuara në këtë vendim, përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të masës së ekuivalentimit dhe të cilësisë së rezultateve.

8. Kandidatët që kërkojnë të studiojnë në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006-2007, dhe që vijnë nga shtetasit sociale si: të verbër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ish-të dënuar dhe ish-të përndjekur politikë nga sistemi komunist, fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të kenë tarifë shkollimi sa gjysma e tarifës së shkollimit të degës përkatëse. Numri i kandidatëve, që përfitojnë nga kjo tarifë, të jetë jo më i lartë se 200. Përzgjedhja e tyre të bëhet në bazë të rezultateve të arritura në shkollën e mesme dhe në provimet e maturës shtetërore.

9. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në kursin e parë të vitit akademik 2006-2007 të jetë:

I. Në Universitetin e Tiranës:

1. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës	15 000 lekë
2. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja	15 000 lekë
3. Në Fakultetin e Drejtësisë	30 000 lekë
4. Në Fakultetin e Shkencave Sociale	30 000 lekë
5. Në Fakultetin e Mjekësisë:	
5.1. në degën e Mjekësisë	25 000 lekë
5.2. në degën e Farmacisë	30 000 lekë
5.3. në degën e Stomatologjisë	30 000 lekë
6. Në Fakultetin e Infermierisë	25 000 lekë
7. Në Fakultetin e Histori-Filologjisë	20 000 lekë
8. Në Fakultetin e Ekonomisë	25 000 lekë

II. Në Universitetin Politeknik:

1. Në degën Arkitekturë	30 000 lekë
2. Në degën Ndërtim	25 000 lekë
3. Në degen Elektrike	20 000 lekë
4. Në degën Elektronike	20 000 lekë
5. Në degët e tjera	15 000 lekë

III. Në Akademinë e Arteve:

1. Në degën Regji Filmi	80 000 lekë
2. Në degët e tjera	30 000 lekë

IV. Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi"

20 000 lekë

V. Në Universitetin Bujqësor:

1. Në degën Drejtëm Fermash dhe Agrobiznes	20 000 lekë
2. Në degën Ekonomi dhe Politikë Agrare	20 000 lekë

3. Në degën Inxhinieri Pyjesh	20 000 lekë
4. Në degën Inxhinieri e Përpunimit të Drurit	20 000 lekë
5. Në degën Veterinari	20 000 lekë
6. Në degët e tjera	15 000 lekë

VI. Në Universitetin e Elbasanit:

1. Në degën Gjuhë-Letërsi	15 000 lekë
2. Në degën Gazetari	15 000 lekë
3. Në degën Punë Sociale	15 000 lekë
4. Në degën Psikologji	15 000 lekë
5. Në degët e tjera	12 000 lekë

VII. Në Universitetin e Gjirokastrës

1. Në të gjitha degët	12 000 lekë
-----------------------	-------------

VIII. Në Universitetin e Korçës:

1. Në të gjitha degët	12 000 lekë
-----------------------	-------------

IX. Në Universitetin e Shkodrës:

1. Në degën Drejtësi	16 000 lekë
2. Në të gjitha degët e tjera	12 000 lekë

X. Në Universitetin e Vlorës:

1. Në degën Drejtësi	20 000 lekë
2. Në degën Gjuhë-Letërsi	15 000 lekë
3. Në degën Pedagogji e Specializuar	15 000 lekë
4. Në të gjitha degët e tjera	12 000 lekë

XI. Në Universitetin e Durrësit:

1. Në të gjitha degët	15 000 lekë.
-----------------------	--------------

10. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët e viteve të tjera më të larta të jetë 12 000 lekë.

11. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, e cila duhet të jetë tarifë shkollimi me kuotë kryesore apo dytësore. Studentët përsëritës i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, me të cilën kanë filluar studimet.

12. Në çdo degë, 5 (pesë) studentë, të vitit të parë, me rezultatet më të larta nga mesatarja e shkollës së mesme dhe provimet e maturës shtetërore, për vitin akademik 2006-2007, nuk do të paguajnë tarifë shkollimi.

13. Studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet nga arsimi i lartë jopublik në arsimin e lartë publik, brenda sistemit tonë të arsimit të lartë, si edhe ata nga jashtë Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të atyre që parashikohen me marrëveshje zyrtare shtetërore, i nënshtrohen tarifës së veçantë të shkollimit me kuotë dytësore.

14. Mënyra e plotësimit të kuotave të parealizuar, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me shkollat e larta dhe universitetet.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KUOTAT KRYESORE TË PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007

Tabela Nr.1

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	Σ
1	Histori	105											105
2	Gjeografi	106											106
3	Histori-Gjeografi												H
4	Gjuhë Letërsi	104			124			225	242				695
5	Edukim Qytetar												H
6	Anglisht	181			79							80	340
7	Frëngjisht												H
8	Italisht												H
9	Gjuhë Sllave Ballkanike												H
10	Gjermanisht												H
11	Gjuhë Letërsi Greke												H
12	Gjuhë Turke												H
13	Cikli i Ulët				165								165
14	Cikli i Ulët Parashkollor												H
15	Fizkulturë										113		113
16	Matematikë												H
17	Fizikë												H
18	Matematikë-Fizikë												H
19	Biologji-Kimi	104											104
20	Kimi												H
21	Kimi Teknologjike dhe ushqimore												H
22	Kimi Industriale												H
23	Matematikë-Informatikë												H
24	Informatikë	60											60
25	Teknologji Informacioni												H
26	Gazetari	80			70								150
27	Punë Sociale	114			96			142					352
28	Filozofi-Sociologji	115											115
29	Pedagogji e Specializuar								25				25
30	Psikologji	113			108			119					340
31	Shkencat Politike	113											113
32	Drejtësi	320						236	200				756
33	Regji Filmi dhe TV									10			10
34	Art Skenik									68			68
35	Arte Figurative									76			76
36	Muzikë									103			103
37	Mjekësi	203											203
38	Stomatologji	64											64
39	Farmacë	64											64
40	Infermieri	374											374
41	Administrim Publik											80	80

42	Administrim-Biznes	423											423
43	Ekonomiks	82											82
44	Financë	424											424
45	Info.Ekonomike	60											60
46	Turizëm											80	80
47	Marketing												H
Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	
48	Inxh. Detare												H
49	Navigacion												H
50	Mekanikë												H
51	Inxh. Materiale												H
52	Tekstil												H
53	Elektrik		90										90
54	Elektronik		125										125
55	Ndërtim		205										205
56	Arkitekturë		98										98
57	Inxh.Matematike												H
58	Inxh.Fizike												H
59	Inxhinier Gjeodet												H
60	Inxhinieri Ambienti												H
61	Inxh. Ne shkencat e tokes												H
62	Gjeoinformatike												H
63	Inxhin. i Gjeoburimeve												H
64	Drejtëm Fermash dhe AGB			178									178
65	Ekonomi dhe P. Agrare			178									178
66	Inxh. Agr.ne Hortikulture dhe MB												H
67	Inxh. Agr. në P. Bimor												H
68	Inxh. Agrar ne Zooteq. dhe B.Blek												H
69	Akuakulturë dhe M. Peshkimi												H
70	Inxh. Agromjedisi												H
71	Tek. Agroushqimore												H
72	Agr. Agroushqimor												H
73	Vreshtari. dhe Enologji												H
74	Inxh. Pyjesh			108									108
75	Inxh. P. Druri			72									72
76	SHL Jouniversitare											160	160
77	Veterinari			117									117
	GJITHESËJT	3209	518	653	642	0	0	722	467	257	113	0	6981

H: Do të thotë kuotë e hapur

KUOTAT DYTËSORE TË PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007

Tabela Nr.2

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	Σ
1	Histori	12											12
2	Gjeografi	12											12
3	Histori-Gjeografi												0
4	Gjuhë Letërsi	12			14			16	8				50
5	Edukim Qytetar												0
6	Anglisht	14			9								23
7	Frëngjisht												0
8	Italisht												0
9	Gjuhë Sllave Ballkanike												0
10	Gjermanisht												0
11	Gjuhë Letërsi Greke												0
12	Cikli i Ulët												0
13	Cikli i Ulët Parashkollor												0
14	Fizkulturë										12		12
15	Matematikë												0
16	Fizikë												0
17	Matematikë-Fizikë												0
18	Biologji-Kimi	12											12
19	Kimi												0
20	Kimi Teknologjike dhe ushqimore												0
21	Kimi Industriale												0
22	Matematikë-Informatikë												0
23	Informatikë	6											6
24	Teknologji Informacioni												0
25	Gazetari	8			8								16
26	Punë Sociale	12			11			8					31
27	Filozofi-Sociologji	11											11
28	Psikologji	13			12			14					39
29	Shkencat Politike	13											13
30	Drejtësi	36						18	20				74
31	Mjekësi	23											23
32	Stomatologji	7											7
33	Farmaci	7											7
34	Infermieri	37											37
35	Administrim Publik												0
36	Administrim-Biznes	42											42
37	Ekonomiks	9											9
38	Financë	42											42
39	Info.Ekonomike	6											6
40	Turizëm												0
41	Marketing												0

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	0
42	Mekanikë												0
43	Inxh. Materiale												0
44	Tekstil												0
45	Elektrik		10										10
46	Elektronik		14										14
47	Ndërtim		23										23
48	Arkitekturë		11										11
49	Inxh.Matematike												0
50	Inxh.Fizike												0
51	Inxhinier Gjeodet												0
52	Inxhinieri Ambienti												0
53	Inxh. Ne shkencat e tokës												0
54	Gjeoinformatike												0
55	Inxhin. I Gjeoburimeve												0
56	Drejtëm Fermash dhe AGB			20									20
57	Ekonomi dhe P. Agrare			20									20
58	Inxh. Agr.ne Hortikulture dhe MB												0
59	Inxh. Agr. në P. Bimor												0
60	Inxh. Agrar ne Zootek. dhe B.Blek												0
61	Akuakulturë dhe M. Peshkimi												0
62	Inxh. Agromjedisi												0
63	Tek. Agroushqimore												0
64	Vreshtari. dhe Enologji												0
65	Inxh. Pyjesh			10									10
66	Inxh. P. Druri			7									7
67	Veterinari			11									11
	GJITHESEJT	334	58	68	54	0	0	56	28	0	12	0	610

KUOTAT PËR KANDIDATËT NGA TROJET PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007

Tabela Nr.3

		KOSOVA						MAQEDONI						MALI I ZI						1							
Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	USH	UE	UPT	UT	UPT	UBT	UE	AA	UK	UT	UPT	USH	AS	AA	UT	UPT	UBT	AA	USH	UE	AS	Σ	
1	Histori	1						1						1												3	
2	Gjeografi	1																	1							2	
3	Histori-Gjeografi				2	2					1					2							1			8	
4	Gjuhe Letersi	1			2						2			1		2			2				1			11	
5	Edukim Qytetar					2					1													1		4	
6	Anglisht	2			2	1		1			1			1		1			1				1			11	
7	Italisht				2	1					1					1							1			6	
8	Gjermanisht				2									1		1							1			5	
9	Turqisht	2						1																		3	
10	Cikli i Ulet				2	3					2		1			2							1			11	
11	CU Parashk.				2	3					2		1			6							1			15	
12	Fizkulturë																1								1	2	
13	Matematikë	2			2			1					1	1		1			1				1			10	
14	Fizikë	3			2			3						1					1				1			11	
15	Biologji-Kimi	1			1	2		1			1			1		1			1				1			10	
16	Kimi e Përgjithme	1												1												2	
17	Kimi Ushqimore	1						1																		2	
18	Kimi Industriale	1						1																		2	
19	Informatikë	1			1			1						1		1			1				1			7	
20	Gazetari	1				1					1								1							4	
21	Punë Sociale	1				2		1			1			1					1							7	
22	Filozofi-Soc.	1						1					1	1					1							5	
23	Psikologji	1			1			1						1		1			1				1			7	
24	Shkencat Pol.	2						1						1												4	
25	Drejtësi	1			1			1						1		1			1							6	
26	Art Skenik		1									1						1					1			4	
27	Arte Figurative		1									1						1					1			4	
28	Muzikë		1									1						1					1			4	
29	Mjekësi	1						1						1					1							4	
30	Stomatologji	1						1						1					1							4	
31	Farmaci	1						1						1					1							4	
32	Infermieri	5			2	4		2			2		2	1		1			1				1			21	
33	Ekonomiks	2						1						1					1							5	
34	Adm.-Biznes	2			1			1					1	1		1			1				1			9	
		K	o	s	o	v	a	M	a	q	e	d		M	a	i	Z	i	1								

Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	USH	UE	UPT	UT	UPT	UBT	UE	AA	UK	UT	UPT	USH	AS	AA	UT	UPT	UBT	AA	USH	UE	AS	Σ
35	Financë	2			1			1					1	1		1			1				1			9
36	Inf. Ekonomike	1						1						1					1							4
37	Turizëm				2								1			2							1			6
38	Mekanikë						2		1						1					1						5
39	Inxh. Materiale						2		1						1					1						5
40	Tekstil						2		1						1					1						5
41	Elektronik																			1						1
42	Ndërtim																			1						1
43	Arkitekturë																			1						1
44	Hidroteknikë																			1						1
45	Inxhin ambienti																			1						1
46	Drejtim Fermash dhe AGB			1						1			2													4
47	Ekonomi dhe P. Agrare			1						1																2
48	Inxh. Agr. në Hortikulturë dhe MB			1						1			2								1					5
49	Inxh. Agr. në P.Bimor			1						1											1					3
50	Inxh. Agr. Në Zootek dhe B.Blektoral.			1						1											1					3
51	Akuakulturë dhe M.Peshkimi			1						1																2
52	Inxh. Agromjedisi			1						1											1					3
53	Tek. Agroushqimore			2						2											1					5
54	Inxh. Druri			3						2											1					6
55	Inxh. Pyjesh			3						2											1					6
56	Veterinari			4						4											1					9
57	Vreshtari dhe Enologji			2						2											1					5
58	GJITHESEJT	39	3	21	28	21	6	25	3	19	15	3	13	22	3	25	1	3	22	8	9	3	16	1	1	309

1. Preshevë, Medregjë, Bujanovcë.

VENDIM
Nr.199, datë 5.4.2006

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME, TË DATËS 19 MARS 2006, PËR KRYETAR, NË KOMUNËN FAJZË TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme, të datës 19 mars 2006, për kryetar, në komunën Fajzë të qarkut të Kukësit, i ndarë, si më poshtë vijon:

- 500 000 (pesëqind mijë) lekë për paga e sigurime;

- 1 000 000 (një milion) lekë për mallra e shërbime.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.201, datë 29.3.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.584, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23, 24 e 25 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Integritimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren e Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr.584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “d” e pikës 19 të kreut III “Përgatitja e projektaktit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d. Vlerësimin e shkallës së përafrimit dhe tabelën e përputhshmërisë me *acquis communautaire* për projektaktet normative, sipas aneksit, që i bashkëlidhet rregullores.”.

2. Pika 25 e kreut IV “Dhënia e mendimeve për projektaktin”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“25. Projektaktet me karakter normativ, që kërkojnë përshtatjen e *acquis communautaire* në legjislacionin vendas, i dërgohen për mendim Ministrit të Integritimit, të shoqëruara me relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë, për verifikimin dhe konfirmimin e shkallës së përputhshmërisë së tyre me

acquis communautaire.

Projektaktet të pashoqëruara me relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë me *acquis communautaire*, sipas aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i kthehen, nga Ministria e Integritimit, institucionit propozues për plotësime të mëtejshme përpara shqyrtimit në Këshillin e Ministrave.”.

3. Në pikën 31 të kreut V “Bashkërendimi i projektakteve” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Mendimi i Ministrit të Integritimit, për vlerësimin ose shkallën e përafrimit të projektakteve normative me *acquis communautaire*, reflektohet në ripunimin e projektakteve nga ministri propozues, duke zhvilluar për këtë qëllim, nëse çmohet e nevojshme, këshillime të përbashkëta ose duke e ridërguar atë për mendim përfundimtar.”.

4. Aneksi “Modeli i relacionit dhe tabelës së përputhshmërisë së projektaktit normativ me *acquis communautaire*”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i bashkëlidhet dhe bëhet pjesë e rregullores së Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 qershor 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS

MODELI I RELACIONIT DHE TABELËS SË PËRPUTHSHMËRISË SË PROJEKTAKTIT NORMATIV ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

1. Evidentimi i institucionit përgjegjës për përgatitjen e projektaktit ose rishikimin e aktit dhe institucioneve bashkëpunuese

Është i detyrueshëm:

a) emërtimi i ministrisë ose institucionit qendror, përgjegjës për përgatitjen e projektaktit ose rishikimin e aktit, si dhe emërtimi/et e njëjësive të brendshme të organit të cilët kanë përgatitur projektaktin ose rishikuar aktin;

b) përcaktimi nëse institucionit në fjalë është përgjigjësi i vetëm (juridiksion ekskluziv), apo nëse projektakti (akti) është përgatitur në bashkëpunim me dy ose më shumë institucione të administratës shtetërore (juridiksion i përbashkët);

c) identifikimi i institucioneve të administratës shtetërore që kanë marrë pjesë në përgatitjen e projektaktit (në rastet e juridiksionit të përbashkët).

Është fakultative: Përshkrimi mbi procesin e këshillimit (ngritja e grupeve të punës, përfshirja e shoqërisë civile etj.).

Përmbledhje: Përshkrim i shkurtër i nevojës, angazhimit apo detyrimit ligjor për hartimin e aktit duke shpjeguar gjithashtu dhe rolin e institucioneve të përfshira në përgatitjen e tij.

Autoriteti drejtues: Emri i institucionit propozues apo drejtues të grupit *ad-hoc* të punës për përgatitjen e projektaktit.

Autoritetet bashkëpunuese: Emri i institucioneve të përfshira në përgatitjen e projektaktit.

2. Statusi i projektaktit të propozuar në rendin ligjor

Është detyrueshëm: Tregimi i pozicionit të aktit normativ në rendin ligjor të brendshëm.

- Në rastin kur projektakti normativ është hartuar në zbatim të një ligji të miratuar nga Kuvendi, duhet të përmendet ligji (titulli i plotë dhe data e botimit në Fletoren Zyrtare) dhe nenet (numri) që do të ekzekutohen.

- Në rastin kur projektakti normativ ekzekuton një VKM, duhet të përmendet VKM (titulli i plotë dhe data e botimit në Fletoren Zyrtare) dhe nenet (numri) që do të ekzekutohen.

- Në rastin kur projektakti normativ shfuqizon dispozita të mëparshme, duhet të paraqiten (tregues të përgjithshëm për të identifikuar projektaktin normativ, nga pjesët e akteve normative që do të shfuqizohen).

- Në rastin kur projektakti normativ është një shkrirje (amendim apo konsolidim) i akteve të tjera normative (të përmendet numri, data dhe titulli i shkurtër i akteve të amenduara).

Përmbledhja duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Projektakti (titull i shkurtër) paraqet një amendim të ligjit nr./datë/titull i shkurtër.

Ose

- Projektakti (titull i shkurtër) ekzekuton dispozitat e ligjit (ose VKM) (nr./datë/titull i shkurtër) për sa i takon (të përmendet shkurtimisht fusha e neneve që do të zbatohen).

Ose

- Projektakte (titull) shfuqizon ligjin (ose VKM) (nr./datë/titull i shkurtër).

Ose

- Projektakti është një shkrirje (amendim apo konsolidime) e dispozitave të ligjit/VKM (nr./datë/titull i shkurtër) dhe ligjit/VKM (nr./datë/titulli i shkurtër).

3. Relacioni i projektaktit:

- Objektivat e propozimit:

Objektivat e përgjithshëm që synon të rregullojë projektakti (të cilat mund të jenë: modernizimi, racionalizimi, trajtimi i një çështjeje, rregullimi i aktiviteteve informuese etj.).

Objektivat specifikë në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (duhet të përmenden dispozitat e MSA-së të cilat synohen të adresohen përmes projektaktit normativ; angazhimet e ndërmarra në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të MSA/Partneriteti Europian; mangësitë e vëna në dukje nga Bashkimi Europian në Raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë, si dhe takimet e formateve të ndryshme Shqipëri-BE).

Hapat e mëparshëm të ndërmarrë për përafrimin e legjislacionit (duhet të shpjegohet nëse projektakti përfaqëson fazën e parë/të dytë/të tretë — për përafrimin e legjislacionit vendas me Rregulloren(t) Direktivën(at) nr..., siç është parashikuar në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të MSA-së).

Ndryshimet e mundshme ose të pritshme të legjislacionit në fuqi si pasojë e miratimit të projektaktit.

Gjithashtu, në rastet kur një pjesë e dispozitave të legjislacionit vendas që do të amendohet apo konsolidohet (Kodi Civil, Kodi Tregtar, Kodi Penal etj.) janë të përafuara me *acquis communautaire*, duhet të përmenden dhe analizohen dispozitat që nuk shfuqizohen në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të këtij akti.

- Përshkrimi i hapave kryesorë të ndërmarrë për përgatitjen e projektaktit normativ

Ky përshkrim duhet të përfshijë:

a) modelin e akteve të ngjashme të vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe/ose të vendeve kandidate të marra parasysh gjatë hartimit të projektaktit;

b) përkthimet në gjuhën shqipe të *acquis* që përafrohet përmes projektaktit normativ;

c) ekspertizën e huaj ose vendase të siguruar me sugjerimin e donatorëve (kur shihet e arsyeshme).

Këto dokumente duhet t'i bashkëlidhen projektaktit.

- Shkalla e synuar e përputhshmërisë me *acquis communautaire*

Kur synohet përafrim i pjesshëm i projektaktit normativ me *acquis*, duhet të pasqyrohen objektivat e përgjithshëm të projektaktit normativ (të përmenden duke cituar dhe analizuar në mënyrë krahasimore pjesët e legjislacionit të BE-së me të cilat do të përafrohet projektakti normativ).

Ose

Kur synohet përafrim i plotë i projektaktit normativ me *acquis*, duhet të inkorporohen/transpozohen/adoptohen dispozitat e evidentuara të legjislacionit të BE-së në projektaktin normativ (të citohen nenet e aktit legjislativ të BE-së, si dhe të bëhet një përmbledhje e dispozitave të projektaktit normativ me aktin legjislativ të BE-së).

- Përputhshmëria e projektakteve normative me *acquis communautaire*:

a) "Plotësisht i përputhshëm" — projektakti normativ është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *acquis communautaire* dhe është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

b) "Pjesërisht i përputhshëm" — projektakti normativ është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *acquis communautaire*, megjithëse nuk përputhet me të gjitha parimet që rrjedhin prej tyre por vetëm me ato më të rëndësishme.

c) "I papërputhshëm" — projektakti normativ bie në kundërshtim me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *acquis communautaire* dhe nuk përputhet me parimet që rrjedhin prej këtyre

dispozitive.

d) “I pazbatueshëm” — nuk ekziston asnjë dispozitë e burimeve parësore apo dytësore e *acquis communautaire* e cila mund të krahasohet me projektaktin normativ për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë së tij.

- Arsytet për përputhshmëri të pjesshme ose për mospërputhje

Nëse synohet përafrim i pjesshëm i projektaktit normativ me *acquis*, ose nuk synohet përafrim i projektaktit normativ me *acquis*, organi kompetent duhet të përcaktojë arsyet, pavarësisht nëse janë ekonomike, financiare, sociale ose të tjera. Arsyetimi duhet të shoqërohet nga referenca në analiza specifike impakti, studime ose dokumente të tjera dhe jo vetëm në konstatimin e arsyes/ve në terma të përgjithshëm.

- Hapat e mëtejshëm të parashikuara për përafrimin gradual deri në përafrimin e plotë të projektaktit normativ.

Duhet të përcaktohet analiza e boshllëqeve për të evidentuar përmbajtjen e fazave të mbetura dhe periudhën kohore brenda se cilës do të adresohet përafrimi i plotë

4. Tabelat e përputhshmërisë

Tabela e përputhshmërisë plotësohet vetëm në rastet kur projektakti normativ përafrohet nga dispozita konkrete të legjislacionit të BE-së dhe/ose legjislacioneve të vendeve anëtare të BE-së dhe atyre kandidatë.

Tabela 1 e përputhshmërisë duhet të përmbajë:

1. Numrin natyror, titullin e plotë dhe numrin në Fletoren Zyrtare të legjislacionit të BE-së që synohet të përafrohet nga projektakti, subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
2. Titulli i projektaktit (aktit), subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
3. Shkalla e përafrimit				
a	b	c	d	e
Pjesët e legjislacionit të BE-së që përafrohen (neni, paragrafi, çështja) (në disa raste mund të përshkruhen citime dhe përmbledhje të <i>acquis</i>)	Parashikimet e projektaktit (aktit) (titulli, seksioni, neni, paragrafi, çështja etj.)	Përputhja e projektaktit (aktit) me legjislacionin e BE-së (i plotë, i pjesshëm ose jo i aplikueshëm)	Arsyet për përputhje të pjesshme	Periudha e parashikuar për arritjen e përputhjes së plotë

Tabela 2 e përputhshmërisë duhet të përmbajë:

1. Titulli i projektaktit (aktit), subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
2. Numrin natyror, titullin e plotë dhe numrin në Fletoren Zyrtare të legjislacionit të BE-së që synohet të përafrohet nga projektakti, subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
3. Shkalla e përafrimit				
a	b	c	d	e
Parashikimet e projektaktit (aktit) (titulli, seksioni, neni paragrafi,	Parashikimet dhe kërkesat e legjislacionit të BE-së (neni,	Përputhja e projektaktit (aktit) me legjislacionin e BE-së (i plotë, i	Arsyet e përputhjes së pjesshme ose të mospërputhjes	Periudha e parashikuar për arritjen e përputhjes së

çështja etj.)	paragrafi, çështja)	pjesshëm ose jo i aplikueshëm)		plotë
---------------	---------------------	--------------------------------	--	-------

Në rastet kur projektakti nuk transpozon dispozita të veçanta të legjislacionit të BE-së, duhet të tregohet subjekti dhe objekti që synojnë të rregullojnë këto dispozita dhe arsyeja për mos transpozimin e tyre (kostot, mungesa e kapaciteteve administrative, konkurrenca në ekonomi, ndikimi social...).

Nga ky rregull bëjnë përjashtim vetëm rastet kur arsyeja për mospërafrimin e dispozitave të *acquis*, ka lidhje me statusin që do të fitohet pas anëtarësimit në BE.

5. Nevoja e plotësimit të tabelës së përputhshmërisë së dispozitave

Tabela e përputhshmërisë së dispozitave duhet të plotësohet bazuar në dy përjasje:

1. duke paraqitur përputhshmërinë ndërmjet dispozitave të legjislacionit të BE-së me atë të projektaktit (aktit);

2. duke paraqitur përputhshmërinë ndërmjet dispozitave të projektaktit (aktit) dhe atyre të legjislacionit komunitar.

Ndryshimi i dispozitave referuese në kolonën e parë të tabelave synon të realizojë:

1. lehtësimin e parashikimit dhe analizimit të përputhshmërisë kur një projektakt (akt) është në proces përafrimi me disa pjesë të legjislacionit të BE-së dhe kur një akt i legjislacionit të BE-së synohet të përafrohet me disa projektakte (akte) të legjislacionit vendas;

2. përcaktimin sa më të plotë dhe të qartë të shkallës së përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire* dhe lehtësimin e procesit të monitorimit dhe raportimit në shërbimet e Komisionit Europian;

3. lehtësimin e krijimit të një baze të dhënash mbi këtë proces si plotësim i kërkesave të bazës së të dhënave të programit TAIEX të Bashkimit Europian dhe në të njëjtën kohë si evidencë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire*;

4. përgatitjen institucionale për përballimin e fazave të mëtejshme të procesit të integritetit europian (fitimit të statusit kandidat, procesit “screening” dhe negociimit të kapitujve të *acquis communautaire* për antarësimin në BE).

6. Përshkrimi i masave zbatuese

Përshkrimi i masave zbatuese duhet të përfshijë:

a) Legjislacionin dytësor që do të miratohet për zbatimin e projektaktit normativ;

b) Masat jolegislative, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative, ngritjen e strukturave zbatuese, kostot financiare dhe ato sociale, kërkesë për asistencë të huaj (të parashikuara në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit/Partneriteti Europian).

7. Konfirmimi i Ministrisë së Integritetit

Ministria e Integritetit miraton shkallën e përputhshmërisë së projektaktit të përgatitur nga institucioni përgjegjës me *acquis communautaire*. Nëse institucioni përgjegjës nuk e ka përgatitur si duhet relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë, Ministria e Integritetit ia kthen atë institucionit përgjegjës për të bërë plotësimet e nevojshme.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

U dorëzua për shtyp më 13.4.2006
Doli nga shtypi më 14.4.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë